

VENDIM
Nr. 744, datë 4.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 78, DATË 7.2.2007,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MASËN, KRITERET DHE
PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-
SANITARE PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 78, datë 7.2.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “...16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj...” zëvendësohet me “...20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj...”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Shërbimi Social Shtetëror i përcjell çdo vit Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përlogaritjen e indeksimit të pagesës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i propozon për miratim Këshillit të Ministrave pagesën e indeksuar për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.”.

3. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimet “ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohen me fjalët “...ministri përgjegjës për çështjet sociale...” dhe “...ministra përgjegjëse për çështjet sociale...”.

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama